

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët Nesrin Lushta kryetare e kolegjit, Avdi Dinaj dhe Nebojša Boričić anëtarë, me bashkëpunëtoren profesionale Mirlinda Mejzini procesmbajtëse, në çështjen penale ndaj të pandehurit M. Sh., për shkak të dyshimit të bazuar se kanë kryer veprën penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 pa.9 lidhur me par.6 të KPK-së, duke vendosur lidhur me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësit të të pandehurit M. Sh. paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Dega në Podujevë PPr.nr.26/2016 të datës 19.10.2016 dhe aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, PN.1.nr.1690/2016 të datës 28.10.2016, në seancën e kolegjit të mbajtur më 22.11.2016, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Me aprovimin e kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësit të pandehurit M. Sh., ndryshohet aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Dega në Podujevë PPr.nr.26/2016 të datës 19.10.2016 dhe aktvendimi i Gjykatës së Apelit e Kosovës, PN.1.nr.1690/2016 të datës 28.10.2016, ashtu që të pandehurit i ndërpritet masa e paraburgimit dhe i njëjti menjëherë pas dorëzimit të aktgjykimit të lirohet për tu mbrojtur në liri.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë – Dega në Podujevë, me aktvendimin PPr.nr.26/2016 të datës 19.10.2016, të pandehurit M. Sh., për shkak të dyshimit të bazuar se ka kryer veprën penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 pa.9 lidhur me par.6 të KPK-së, ia ka vazhduar masën e paraburgimit për 1 (një) muaj e cila do të llogaritet nga data 19.10.2016 deri më 19.11.2016.

Masa e paraburgimit është caktuar në bazë të nenit 187 par.1 nënpar. 1.2 pikat 1.2.1, dhe 1.2.2 të KPPK-së.

Në procedurën ankimore, gjykata e Apelit e Kosovës me aktvendimin PN.1.nr.1690/2016 të datës 28.10.2016, e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e mbrojtësit të të pandehurit dhe e ka vërtetuar aktvendimin e shkallës së parë.

Paraqitësi i kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë dhe pretendimet e tij.

Kundër këtyre aktvendimeve, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka ushtruar mbrojtësi i të pandehurit M. Sh., av. F. A., për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të Kodit të Procedurës Penale neni 383. 1.1 në kuptim të nenit 384 2.1 të KPPK, shkeljes të së dejtës e cila është e garantuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, neni 415.1.1 të KPPK dhe neni 187 të KPPK, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës ta ndërpres paraburgimin ose të caktojë ndonjë nga masë më të butë.

Në kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë mbrojtësi i të pandehurit kryesisht thekson se nuk ekziston rreziku i shmangies nga ndjekja penale përkatësisht rreziku i ikjes pasi që i pandehuri e ka vendbanimin, vendin e punës dhe familjen në Kosovë, se rreziku i ndikimit në dëshmitar nuk është arsyetuar nga Gjykata e shkallës së parë e as nga ajo e shkallës së dytë, se ky rrezik duhet të provohet me rrethana konkrete dhe jo vetëm të paramendohet ndikimi i mundshëm, se masa e paraburgimit shkakton dëme sociale për të pandehurin dhe familjen e tij për arsye se gruaja e tij është operuar nga syri dhe të njëjtës i nevojitet kujdesi i shtuar mjekësor të cilin mund ta sigurojë vetëm i pandehuri, si dhe njëkohësisht i njëjti është edhe mbajtës dhe kujdestar i dy fëmijëve të mitur.

Opinionit i Prokurorit të Shtetit lidhur me kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë.

Prokurori i Shtetit i Kosovës, me shkresën KMLP.III.nr.220/16 të datës 21.11.2016, ka propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të të pandehurit M. Sh. të refuzohet si e pabazuar.

Gjetjet e Gjykatës Supreme

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit, i shqyrtoi shkresat e lëndës, vlerësoi pretendimet e kërkesave, dhe gjeti se:

- kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është e bazuar.

Gjykata Supreme pas shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe kërkesës së mbrojtësit të të pandehurit, vlerësoj se aktvendimet e kundërshtuara duhen ndryshuar dhe i pandehuri duhet liruar nga masa e paraburgimit, për arsye se këto aktvendime janë të paqëndrueshme, për çka me të drejtë tërheq vërejtjen mbrojtësi në kërkesën e tij.

Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, së pari si gjykata e shkallës së parë po ashtu edhe ajo e shkallës së dytë me rastin e vazhdimit të paraburgimit nuk kanë dhënë arsye të qarta dhe të pranueshme sa i përket arsyeve- bazave ligjore për masën e paraburgimit, ngase nuk është dhënë asnjë arsye ligjore konkrete, përpos që janë parafrazuar dispozitat ligjore pa i mbështetur fare përfundimet e tyre në rrethana ligjore, e që vendimet i bëjnë të paligjshme. Në rastin konkret gjykatat përpos një parafrazimi të ligjit nuk kanë bërë asnjë përpjekje për të dhënë arsyet për bazat ligjore të paraburgimit. Andaj, sipas vlerësimit të kësaj gjykate nuk qëndron fakti se i pandehuri do të mund të ikë - arratiset ose të ndikojë në dëshmitarët e përmendur ngase në shkresat e lëndës nuk ekziston asnjë provë bindëse që do të vërtetonte një fakt të till, nga se të pandehurit i dihet vendbanimi dhe adresa e sakt, gjithashtu është edhe mbajtës i familjes dhe baba i dy fëmijëve të mitur.

Për arsyet e lartcekura e në bazë të nenit 438 par. 1 nënpar.1.1 të KPPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS PRISHTINË

Pml.nr.294/2016 datë 22.11.2016.

Procesmbajtësja,
Mirlinda Mejzini

Kryetare e kolegjit,
Nesrin Lushta